



A C A D E M Y



SPARKLAB ACADEMY

Sparklab Academy rritet, transformohet dhe rinovohet në hap me inovacionin teknologjik dhe hap dyert e trajnimit për të gjithë të interesuarit në botën e ICT!

Profesionistët ekspertë të sektorit do të trajnojnë profesionistët e rinj të së ardhmes dhe do të shoqërojnë talentet drejt një pozicionimi pune konkret në botën e ICT-së.

Në këtë kontekst, **SPARKLAB ACADEMY** synon të jetë çelësi hyrës:

- Për ata që kërkojnë një pozicionim në tregun e punës.
- Për ata që duan të zhvillojnë aftësitë e tyre për t'u rritur profesionalisht.
- Për kompanitë që janë në kërkim të talenteve të rinj ose që duan të rrisin stafin e tyre të brendshëm.





Zhvillimi teknologjik kërkon gjithnjë e më shumë një përditësim të vazhdueshëm të aftësive si në sektorin specifik të ICT-së ashtu edhe në fusha të tjera të biznesit. Kjo nënkupton një vizion të ri të funksionit E&T (Education & Training), të modeleve të ofrimit dhe përdorimit të tij. Kemi të bëjmë me një transformim të madh, ku metodat e aksesit në trajnime, mjetet në dispozicion dhe kanalet e hyrjes në botën e punës përbëjnë në tërësinë e tyre faktorin e suksesit të iniciativave E&T (Education & Training).

Në **Sparklab Academy**, ne besojmë në trajnimin profesional.

Ndër vite kemi pasur konfirmim se pasioni, përkushtimi, interesi dhe kurioziteti, të shoqëruara me trajnime shumë të specializuara, janë kombinimi perfekt për të krijuar profesionistë të rinj dhe për të futur talente të reja në botën e punës së Teknologjisë së Informacionit.

MËSO NGA E ARDHMJË!





Sparklab Academy përmes trajnimit të lartë të specializuar të trajnuesve dhe profesionistëve në sektorin e ICT-së:

- Ndjek synimin për të trajnuar dhe drejtuar brezin e ri të talenteve.
- Nxit dhe përshejton hyrjen e talenteve të rinj në botën e punës
- Propozon dhe inkurajon shtigjet e kualifikimit dhe rritjes

MISIONI

**TRAJNUESIT E SOTËM
DO TË JENË KOLEGËT E TU NESËR**

V
L
E
R
A
-

Pasioni

Cilësia

Inovacioni

Përfshirja

Qëndrueshmëria

Transparenca

Integriteti



Kursi i programimit JAVA



Kujt i drejtohet: Të diplomuarve në disiplinat informatike, të diplomuar ose në proces diplomimi në disiplina shkencore, teknike dhe IT.

Grupmosha: 16 – 30 vjeç

KURSI



PËRSHKRIMI



Sparklab Academy në bashkëpunim me klientë të rëndësishëm të ICT-së, organizon një kurs trajnimi që zgjat 5 javë në **PROGRAMIM JAVA FULL STACK**.

Ne ofrojmë një kurs trajnimi të strukturuar në mënyrë që të diplomuarit, ose studentët në disiplinat shkencore, teknike dhe IT, të kultivojnë pasionin e tyre dhe ta transformojnë atë në një profesion të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Duke filluar me një kurs që përfshin tema bazë të programimit “object-oriented”, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të zbulojnë aftësitë e tyre IT dhe të specializohen në botën e programimit Java si në front-end dhe në back-end.

KURSI



INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Profili profesional i zhvilluar:

Zhvillues Java

Mënyra e trajnimit:

Klasa të zhvilluaranga ekspertë
të industrisë.

Metodologjia:

“Learning by doing”.
(Mësime teorike alternuar me
praktikë në projekte)



KURSI



PROGRAMI

Moduli 1



KURSI

Prezantimi, qëllimi i kursit dhe bashkëbisedim njohës me studentët

Struktura e programimit JAVA;

Instalimi i mjediseve të zhvillimit: JDK, dhe IDE (**IntelliJ**);

Llojet primitive dhe variablat;

Operatorët dhe shprehjet;

Strukturat e kushtëzuara dhe përsëritëse (**IF-ELSE, FOR...**);

Break, continue e return;

Array;

Thellimi në strings dhe metodat e tij;

Try-catch-finally dhe menaxhimi i Exception;

Funksionet statike

Ushtrimi përfundimtar:

krijimi i një aplikacioni konsol



PROGRAMI

Moduli 2



Hyrje në programimin OOP;

Koncepti i klasës, objektit dhe konstruktorit;

Objektet wrapper, cast, packages;

Menaxhimi i te dhenave me Data;

Enum;

Kapsulimi dhe information hiding;

Koleksionet Themelore: List & Set;

Trashëgimia dhe Polimorfizmi;


Ndërfaqet dhe klasat abstrakte;

Thellimi në koleksione: Map;

Ushtrimi përfundimtar:

krijimi i një aplikacioni të konsole OOP

KURSI



PROGRAMI

Moduli 3



KURSI

Hyrje në databazat relacionale dhe SQL;

Instalimi i mjediseve të zhvillimit
MySQL dhe të client (**HeidiSql**);

Krijimi i DB dhe tabelave;

Marrëdhëniet ndërmjet tabelave: 1-1, 1-n, n-n;

Foreign key, llojet e Join;

Hyrje në query-t e thjeshta:
SELECT, INSERT, UPDATE, DELETE;

Veprime filtrimi:
DISTINCT, GROUP BY, ORDER BY, LIKE...;

Subquery;

Views;

Constraints;

COMMIT e ROLLBACK;

Konceptet e triggers e stored procedure;

Hyrje në JDBC;



PROGRAMI

Moduli 4



KURSI



Hyrje në framework Spring;

Koncepte si:

Design Pattern, IoC, DI dhe pom.xml;

Spring boot, Spring Web, Tomcat dhe koncepti i web server;

Protokolli HTTP, veprime CRUD e REST services;

Hyrje në Spring data JPA dhe Hibernate;

Shtresëzimi i një Web API:
repository, service, controller e
përdorimi i Autowired;

Koncepte si @Entity e @Table,
qasja code-first & not;

Komunikimi me DB
nëpërmjet query native, HQL e JPQL



PROGRAMI

Moduli 4

Business logic:
Prezantimi i ndërfaqeve Service
dhe implementimit të tyre;

Krijimi i RESTcontroller për ekspozimin
e API-ve në lokal;

Bazat e Spring Security: konceptet
bazë të JWT token e Bearer;

Studim i thelluar i varësive të rëndësishme:
Lombok e Swagger;

Ushtrimi përfundimtar:
krijimi i një Web API



KURSI



PROGRAMI

Moduli 5

Përsëritje e tematikave më të rëndësishme, sqarime, përgjigje dhe interaktivitet me studentët.

Konceptet themelore të HTML e CSS;

Instalimi i node.js e IDE VSC;

Framework Bootstrap e grid system;

Extra: tools të rëndësishëm në punë (**GIT** e **JIRA**);

Ushtrimi përfundimtar:
zhvillimi i një ndërfaqeje të thjeshtë grafike që lidhet me web API-n e javës 4.



KURSI





TARIFA E ÇERTIFIKIMI

Bursa Studimi dhe Mundësi Punësimi

Në përfundim të kursit studenti pajiset me një Çertifikatë të formimit profesional liçencuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

